VENDIM
Nr. 140, datë 26.12.2014

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË PËR VITIN 2015

Në mbështetje të neneve 9dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009,të ndryshuar, vendimit nr. 78, datë 26.6.2008, "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë(ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë, për vitin 2015 dherelacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Tarifa e energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2015 do të jetë 3.0 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti